

Dr. Arbnora DUSHI
(Instituti Albanologjik – Prishtinë)

Bio e shkurtër

Këshilltare shkencore - është folkloriste dhe antropologe kulturore nga Prishtina, me kontribute të rëndësishme në studimet e folklorit shqiptar. Ajo ka përfunduar doktoratën në Universitetin e Prishtinës, me titull “Rrëfimi personal gojor si lloj i folklorit” si dhe studimet post-doktorale në Turku të Finlandës. Karriera e saj përfshin qëndrime kërkimore në SHBA, Finlandë, Spanjë, Austri dhe Itali, të fokusuara në antropologji kulturore dhe folklor. Që nga viti 1997 është pjesë e Degës së Folklorit në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ndërsa që nga viti 2019 e udhëheq atë. Është aktive në asociacione akademike ndërkombëtare si SIEF, ISFNR, InASEA, dhe Finnish Folklore Felloës. Është nënkryetare e organizatës ndërkombëtare “Kommission für Volksdichtung” si dhe anëtare e bordit këshilldhënës të “Kosovo Oral History”. Në kërkimet e saj, Dushi përdor qasje interdisiplinare duke u mbështetur në teoritë e folklorit, antropologjisë dhe historisë gojore. Ajo analizon jo vetëm përmbajtjen e rrëfimeve, por edhe mënyrën se si ato ndërtohen, rrëfohen dhe kontekstualizohen nga individët, duke theksuar rolin aktiv të subjektit në formësimin e kuptimit të së kaluarës. Interesi i saj për historinë gojore shtrihet në dokumentimin dhe interpretimin e rrëfimeve personale si burime të vlefshme për të kuptuar proceset historike. Monografia e saj e fundit “Folklori si kujtesë e praktikë” (2021) ofron një perspektivë të re për folkloristikën shqiptare.

Titulli: Kufiri politik si moment kthese në jetë: Rrëfimi personal gojor në shërbim të historiografisë.

Abstrakt

Ky hulumtim trajton vendosjen e kufirit politik ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitin 1948 si një pikë kthese që ndikoi thellësisht në jetën e banorëve të zonave kufitare. Pyetja që udhëheq analizën time është: Si u përjetua nga individët vendosja e kufirit dhe çfarë thonë rrëfimet e tyre për mënyrën se si vendimet politike transformojnë jetën e përditshme? Hulumtimi bazohet në metodologjinë e historiografisë gojore (oral history), duke analizuar intervista të thelluara me banorë të fshatrave dhe qyteteve kufitare. Përmes rrëfimeve personale, evidentohen mënyrat në të cilat vendosja e kufirit ndikoi në përditshmëri, në perceptimin e hapësirës, në marrëdhëniet familjare e shoqërore, si dhe në ndërtimin dhe rinegocimin e identitetit lokal. Kufiri, në këtë kuptim, nuk paraqitet vetëm si një vijë ndarëse territoriale, por si një realitet i ri social dhe simbolik që i jep formë të përvojës individuale dhe kolektive. Duke u mbështetur në përvojat e jetuara, kam synuar të gjurmoj se si një vendim politik i nivelit shtetëror ndikon drejtpërdrejt në jetën e individit, madje me pasoja konkrete dhe shpesh të papritura. Qasja interdisiplinare integron teoritë mbi

kufijtë dhe konceptin e “momentit të kthesës” në jetën individuale, duke krijuar një lidhje analitike midis strukturave politike dhe përvojës subjektive. Referencat teorike mbështesin idenë se historinë nuk e përbëjnë vetëm dokumentet dhe vendime shtetërore, por edhe rrëfimet e përditshme që pasqyrojnë mënyrën se si individët e kuptojnë dhe përjetojnë ndryshimin. Në këtë mënyrë, studimi thekson rëndësinë e dokumentimit të historisë së përjetuar si një burim thelbësor për historiografinë. Ai synon të kontribuojë në rishikimin e narrativave historike të periudhës pas Luftës së Dytë Botërore, duke vendosur në qendër përvojën personale si një element të rëndësishëm interpretimi për ndryshimet historike.

Fjalë kyçe: *kufiri Shqipëri–Jugosllavi, 1948, historiografia gojore, përvoja e jetuar, zonat kufitare.*